

Është gjithmonë e vështirë t'i përkufizosh pushimet brenda një katrori të mbyllur si thjesht pushime të mira apo thjesht pushime të këqija.

Dhe koncepti i Olive Mill lindi si një nevojë e thellë për të rindërtuar konceptin e të pushuarit bukur... dhe gjatë, në çdo periudhë të vitit, në zemër të rivierës Mesdhetare. Në Llaman.

Olive Mill është një strehë e ngritur tek nivelet jo shumë të rregullta të vijës bregdetare joniane me një farë distance nga deti (rreth 400 m nga plazhi i Llamanit dhe rreth 2 km larg plazhit të Potamit, Himarë).

Asgjë nuk është e rastësishme.

E gjithë zona rezidenciale shtrihet mes ullishteve duke na risjellë edhe njëherë ndërmend simbolikën e Ullirit, po aq sa për gjithë bukuritë natyrore të Jugut të Shqipërisë, të cilat tanimë ka ardhur momenti të jenë një eksperiencë, jo thjesht një fazë vëzhguese dhe prekëse në sipërfaqe.

Gjiri dhe plazhi i Llamanit janë pasojë e derdhjes dhe gërryerjes së Përroit të Thatë që buron prej Himarës, duke formuar kështu plazhin piktoresk plot me forma morfologjike të bregdetit.

Gjiri i Llamanit ndodhet 3 km në jug të Himarës dhe përbëhet nga skaje shkëmbore (sidomos skaji jugor nga ku formohet një greminë rreth 30 m e lartë).

Pjesa tjetër e bregut formon një plazh zallor të formuar nga zaje dhe çakëlla të sjella nga Përroi i Thatë. Në jug gjenden dhe burime ujore nëndetare.

Klima tipike mesdhetare, përpos dimrit të butë dhe verës së nxehtë, përkthehet edhe në një pranverë totalisht të paqëndrueshme, e me një vjeshtë të gjatë, relativisht të thatë e më të ngrohtë se pranvera.

Çfarë do të thotë kjo?

- Që shuma e orëve me diell në Llaman është 2442 orë/vit
- E shuma e ditëve me diell në Llaman është 136 ditë/vit

Të gjitha këto, duke përfshirë dhe florën dhe faunën e pasur, formojnë një skenë me vlera ekologjike, potenciale jo veç për turizëm apo sporte, por për një jetesë sezonale dhe ndërsezonale të qëndrueshme.

Tek Olive Mill është krijuar hapësira e duhur si për zhytjen dhe peshkimin, aq edhe për çiklizmin, alpinizmin apo vrapin në pistë.

Njësoj siç mundësitë për të parë një delfin janë të njëjta me mundësitë për të hasur ndonjë dhelpër, nuselalë apo lepur të egër.

Aktivitetet në Olive Mill janë organike, duke ndërthurur dhe prekur edhe nivelin malor edhe atë detar brenda të njëjtave pushime.

Domosdoshmëria e komunikimit me natyrën, sa më pranë natyrës, është e lashtë sa vetë krijimi i njerëzimit.

Po aq i lashtë është edhe Ulliri.

Por si mund të ndërtosh një faqe të re pushimi nën zërin e përbashkët kolektiv?

Disa objekte statike mund të gjenerojnë biseda të reja. E më tej akoma, një fat të ri.

Dikur një fabrikë e përpunimit të ullirit, nga e cila mbeti veç një mulli i harruar e i amortizuar. Sot, një koncept i ri i transformimit.

Olive Mill nuk është dokumentimi i një ndërtimi. Olive Mill është dëshmia e një metamorfoze, e një atmosfere së bashku me ndjesitë që ajo përcjell. E gjitha si një shembëlltyrë e gjërave që janë krijuar, kanë ndodhur, janë harruar.

Qëllimi i përbashkët është që gjithë kjo shembëlltyrë e transformuar të përkthehet në një të tanishme të vazhdueshme.

Për t'i dhënë formë të dukshme kësaj, na ndihmoi studioja arkitekturore AndreaCaputo.com

Filozofia e tij në riaktivizimin e hapësirave ekzistuese dhe rileximin e trashëgimisë industriale u përputh drejtpërdrejt me aspiratat tona për ndërgjegjësimin e marrëdhënies së veçantë që kemi me hapësirën në natyrë dhe me aspiratat tona për një zhvillim të qëndrueshëm.

Ish-Fabrika e Vajit të Ullirit të Llananit, Olive Mill, është më shumë se një rezidencë. Është një komunitet.

Aty gjen WELLNESS & SPA, pistë vrapimi, pishinë dimërore, agroturizëm, apartamente, shesh, pazar, prodhime artizanale, siguri, luks, komoditet, qetësi, meditim.

Të gjithë e dimë që ekologjia, teknologjia dhe trashëgimia kulturore ndërtojnë hapësira më inteligjente, por edhe më humane.

I gjithë ky bashkim i materialeve dhe elementeve të ndryshëm nuk është dhe aq i papritur. Objektet e mbetura nuk mund të jenë veç për t'u parë. Ato janë hapësira për t'u jetuar.

Memorja jonë ndryshon gjithë kohës, duke marrë formë përmes eksperiencave tona.

Kështu një fabrikë ulliri mund të kthehet në një përjetim agroturistik tradicional e modern, të cilin do duash ta përsëritësh herë pas here përgjatë një viti.

Në ndërtimin e Olive Mill jemi marrë me format, duke qenë se ngjyrat janë aset i vetë natyrës së Llananit.

Ndërtesat në Olive Mill janë përgjigjja e nevojës për një hapësirë që ka hapësirë si për soditje, ashtu edhe për ndërhyrje në aktivitete.

- Ti mund të degustosh vajin e ullirit, por ti edhe mund ta vjelësh ullirin
- Ti mund të shëtisësh në shesh, por edhe të mësosh recetën e glikosë
- Ti mund të dëgjosh muzikë, por edhe mund t'ia marrësh një isoje

Isoja është mbështetje, aprovim, unanimitet, ka thënë Kadareja.

Atë unanimitet që arrin isoja, ëndërrojmë dhe ne në Olive Mill.

Sado që të ecim, kudo që të shkojmë, në fund gjithmonë do përfundojmë të ndërlidhur me gjeneratat, kohën dhe vendin që na ka bashkuar gjithmonë.

Kurse hapësira flirton gjithë kohës me lehtësinë e të jetuarit mirë.

Sepse çfarë është e bukura?

- E anasjellta e mendjelehtësisë. Bukuria e vërtetë ndodh veç kur e prekshmja dhe e paprekshmja shfaqen në një pikë.

Duke gjetur dritën speciale, këndin ideal të pushimit, mund t'i ndryshosh njerëzit.

Sepse ndërtesat më të mira, më të bukura, janë pushime më të mira dhe eventualisht na bëjnë edhe njerëz më të mirë.